

DEKLARATA
E STUDENTËVE
TË GOTEBORGUT

25 MARS 2001

Parathënie

Ne përfaqësuesit e studentëve në Europë, të mbledhur në Goteborg në Konventën e Studentëve të Goteborgut e mbajtur nga 22-25 Mars 2001, miratuar deklaratën e mëposhtme mbi të ardhmen e Procesit të Bolonjës. ESIB- Unionet Kombëtare Studentore në Europë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të përfshira aktivisht në krijimin e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Në Qershor 1999, ESIB- dhe anëtarët e saj, unionet kombëtare studentore në Europë duhet të vetëftoheshin në takimin ministror mbi “Një Hapësirë të Arsimit të Lartë European” në Bolonjë. Dy vjet më vonë, në Samitin e Pragës, ESIB është referuesi kryesor. Njohja gjithnjë e më shumë e kontributit të studentëve në këtë proces është rezultat i një marrëveshje të rëndësishme të studentëve europianë për të ngritur më lart cilësinë, pranueshmërinë dhe shumëllojshmërinë e arsimit të lartë në Europë.

Hyrje

ESIB-i e shikon procesin e Bolonjës si hapin vendimtar drejt një Europe pa kufij për qytetarët e saj. Hapësira e arsimit të lartë europian duhet të përfshijë mbi të njëjtën bazë të gjithë studentët europianë. Krijimi i kësaj hapësire është një përgjegjësi e përbashkët e të gjithë shteteve europiane dhe duhet të marrë gjithashtu në konsideratë ndryshimet politike dhe social-ekonomike në Europë. Arsyeja për krijimin e një hapësire Europiane të arsimit të lartë është përmirësimi i të gjithë sistemeve kombëtare të arsimit të lartë, nëpërmjet përhapjes së përvojave të mira dhe nxitjes së bashkëpunimit dhe solidaritetit mes shteteve Europiane.

Implikimet sociale

Edhe pse Deklarata e Bolonjës nxorri në pah aspektet kryesore të dimensionit European në arsimin e lartë, ajo nuk adresoi implikimet sociale që ka procesi lidhur me studentët. Arsimi i lartë i aftëson studentët të përvetësojnë shprehitë dhe njohuritë që atyre do t’u nevojiten më tej në jetë, si në aspektin personal dhe në atë profesional. Kontributet sociale dhe qytetare duhet të luajnë rolin e funksioneve parësore të institucioneve të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë janë aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile, dhe në këtë mënyrë në të duhet të përfshihen të gjithë anëtarët e komunitetit të arsimit të lartë. Në këtë rast studentët nuk janë konsumatorë të një shërbimi të tregtueshëm arsimor, dhe

si rrjedhojë është përgjegjësia e qeverisë të garantojë që të gjithë shtetasit të kenë mundësi të njëjta pranimit në arsimin e lartë, pavarësisht nga shtresa e tyre sociale. Kjo nënkupton sigurimin e fondeve të përshtatshme për studentët në formën e bursave shkollore, dhe fonde të mjaftueshme për institucionet e arsimit të lartë për ushtrimin e detyrave të tyre publike.

Hapësira e Arsimit të Lartë

Sikurse u theksua dhe më lart, cilësia e mirë e institucioneve të arsimit të lartë është e një rëndësie të veçantë në një shoqëri demokratike europiane. Mundësia e pranimit dhe shumëllojshmëria, tradicionalisht kanë qenë bazat e arsimit europian dhe e tillë duhet të mbetet edhe në të ardhmen. Përveç kësaj, për të garantuar përputhshmërinë dhe këmbëvlerësinë e të gjithë programeve të institucioneve të arsimit të lartë, në mbarë Europën duhet të vihet në funksionim një sistem kreditesh i bazuar në ngarkesën e punës. Për këtë nevojitet një strukturë e përbashkët Europiane e kritereve të akreditimit dhe një sistem i përputhshëm gradash, për të garantuar në këtë mënyrë që kriteret e grumbulluara në shtete ose në institucione të ndryshme janë të transferueshme dhe çojnë drejt një grade të njohur . Një sistem i bazuar në dy cikle gradash duhet të garantojë hyrje të lirë dhe të njëjtë për të gjithë studentët dhe nuk duhet të çojë në dëbimin e studentëve drejt fushave të tjera akademike. Për të garantuar dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë, nevojitet gjithashtu një bashkëpunim i fortë europian ndërmjet sistemeve kombëtare të sigurimit të cilësisë. Akreditimi, si certifikim i një programi, përveç kritereve të tjera merr parasysh dhe procesin e sigurimit të cilësisë dhe duhet të përdoret si një mjet për nxitjen e cilësisë.

Hapësira Europiane e Arsimit të Lartë për nxitjen e përmirësimit dhe bashkëpunimit kërkon lëvizshmërinë fizike të studentëve, stafit mësimdhënës dhe të studiuesve. Lëvizshmëria është gjithashtu një mënyrë për promovimin e të kuptuarit kulturor dhe të tolerancës. Pengesat për lëvizshmërinë ekzistojnë jo vetëm në botën akademike. Gjithashtu duhet të hiqen dhe pengesat sociale, ekonomike dhe politike. Qeveritë duhet t'i garantojnë studentëve të huaj të njëjtat të drejta ligjore që kanë studentët vendas, dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të marrin përsipër përgjegjësinë t'u ofrojnë studentëve programe të lëvizshme.

Krijimi i një hapësire të vërtetë të arsimit të lartë në Europë ashtu sikurse u përmend dhe më lart do të çojë në një lëvizshmëri më të zgjeruar, në një cilësi më të mirë dhe në rritje të tërheqjes së arsimit dhe kërkimit Europian. Masat e marra në procesin e Bolonjës janë vetëm një hap i parë drejt transparencës.

Ende duhet të inkurajohet sigurimi i një informacioni të përgjithshëm. Për të përmirësuar nivelin e informacionit, Europa duhet të vëre plotësisht në punë përdorimin e Shtojcës së Diplomës dhe krijimin e një baze të gatshme të dhënash me të gjithë informacionin që lidhet me arsimin e lartë.

Roli i studentëve

Së fundi, duhet të theksohet se studentët, si partnerë kompetentë, aktivë dhe konstruktivë, duhet të shihen si një prej forcave drejtuese për ndryshime në fushën e arsimit. Pjesëmarrja e studentëve në procesin e Bolonjës është një nga hapat kryesorë drejt një përfshirje më të qëndrueshme dhe më të formalizuar të studentëve në të gjithë organizmat vendimarrëse dhe në të gjitha diskutimet që lidhen me arsimin e lartë në nivelin Europian.

ESIB – Unionet Kombëtare Studentore në Europë, përfaqësuese e studentëve në nivelin Europian, duhet të përfshihen në deklaratën e ardhshme vijuese të Bolonjës.

ESIB – Unionet Kombëtare Studentore në Europë do të angazhohen për të vazhduar përfaqësimin dhe promovimin e pikëpamjeve të studentëve në nivelin Europian.